



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës së Kuvendit

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 15. 01. 2010, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni-Kaloshi, Kolë Berisha, Dzezair Murati, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Ahmet Isufi, Suzan Novobrdaliu, Besa Gaxherri dhe Radmila Vujovic.

Pjesëmarrës të tjerë: Bletë Bejtullahu ICO, Floriana Shala OSBE, Rrezarta Ahmeti KDI, Shefki Kastrati NDI, Rinor Beka NDI.

Të pranishëm nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni-Kaloshi - kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22 dhjetor 2009;**
- 3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve plotësuese në projekt-Rregulloren e Kuvendit;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratohet rendi i ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve plotësuese në projekt-Rregulloren e Kuvendit;

Besa Gaxherri lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se nuk pajtohet me shqyrtimin e amendamenteve plotësuese, përveç amendamenteve të Komisionit për Integritet Evropian. Amendamente të tjera tha se nuk i konsideron të pranueshme.

Hydajet Hyseni vërejtjen e deputetes Besa Gaxherri tha se e konsideroj të drejtë, por Komisioni është akorduar që ti inkorporoj amendamentet e Komisionit për Integritet dhe disa plotësime të natyrës teknike. Propozoi këto plotësime:

- Të korrigohet titulli i Rregullores si vijon:
“Rregullore e Kuvendit të Kosovës”
- Të lekturohet dhe redaktohet teksti i rregullës 6.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këto plotësime.

Hydajet Hyseni propozoi që në rregullat 7, 8 dhe 9 të Projekt-rregullores shprehjet **“Konstituim i Kuvendit dhe Mbledhje Konstituive e Kuvendit”** të zëvendësohen me shprehjet: **“Konstituim i Legjislaturës së Kuvendit dhe Mbledhje konstituive e Legjislaturës së Kuvendit”**

Besa Gaxherri tha se ky amendament është i panevojshëm, dhe se nuk përkrahë asnjë amendament tjetër përveç atyre të Komisionit për Integritet Evropiane.

Ahmet Isufi mendon se nuk ka nevojë të bëhet ndryshim tek mbledhja konstituive, pasi që nënkuptohet se bëhet fjalë për çdo mandat të ri që vjen. Komisionit nuk i është kthyer në shqyrtim të sërishëm Draft Rregullorja, që ne ta shqyrtojmë dhe të propozojmë amendamente plotësuese.

Hydajet Hyseni tha se pasi që na është krijuar hapësira për plotësim me amendamentet të Komisionit për Integritet Evropiane është mirë të bëhen edhe disa plotësime të natyrës teknike .

Komisioni pas shqyrtimit të propozimeve për ndryshime, miratoi këto amendamente

Amendamenti 1

Në rregullat 7, 8 dhe 9 të Projekt-rregullores shprehjet **“Konstituim i Kuvendit dhe Mbledhje Konstituive e Kuvendit”** të zëvendësohen me shprehjet: **“Konstituim i Legjislaturës së Kuvendit dhe Mbledhje konstituive e Legjislaturës së Kuvendit”**

Amendamenti 2

Pas rregullës 15.3 shtohet paragrafi i ri si vijon:

“4. Kryesia shqyrton strategjinë ligjvënëse dhe raportuese të Qeverisë, e inkorporon dhe e harmonizon me programin e punës së Kuvendit.”

Amendamenti 3

Në rregullën 20.3 fjalia e fundit shndërrohet në paragraf të veçantë si vijon:

“4. Grupi i ri i formuar më vonë nuk mund të ketë emër të njëjtë me ndonjë grup ekzistues parlamentar.”

Amendamenti 4

Në rregullën 50.1. c) pas fjalës **“Evropian”** shtohen fjalët **“dhe tabelën krahasuese me aktet të cilave iu referohet.”**

Amendamenti 5

Në rregullën 53.1 pas fjalëve **“Komisioni për Integritet Evropiane”** të shtohet”, **Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.**

Hydajet Hyseni propozoi që pas rregullës 53.3 ose nëse i referohemi nënve , pas nenit 57.3 , të shtohet paragraf i ri :

“Në rast mungese të përfaqësuesit të ministrisë, Komisioni mund ta heq nga rendi i ditës shqyrtimin e projektligjit”.

Besa Gaxherri tha se nëse ne do ta mundësojmë këtë amendament , atëherë do ti mundësohet ministrit që të mos vij në mbledhjet e Komisionit, por ta dërgojë ndonjë këshilltarë të tij.

Daut Beqiri tha se ky paragraf, do të ishte më mirë të inkorporohet në fund të rregullës 60.2.

Komisioni miratoi këtë propozim si vijon:

Amendamenti 6

Në fund të rregullës 60.2 shtohet teksti:

“Në rast mungese të përfaqësuesit të ministrisë, Komisioni mund ta heq nga rendi i ditës shqyrtimin e projektligjit.”

Komisioni në vazhdim miratoi këto ndryshime:

Amendamenti 7

Në shtojcën nr. 4 rregulla 1.1 në fund të fjalisë shtohen fjalët **“në pajtim me ligjin.”** dhe fjalia në vijim shndërrohet në paragrafin 2.

Amendamenti 8

Në shtojcën nr. 4 rregulla 3.1 ndryshohet si vijon:

“Përveç të të ardhurave mujore të përcaktuara me Rregullën 2.1, Deputetit i takon kompensimi shtesë – mëditja për pjesëmarrje në seancat plenare, komisionet e Kuvendit, ose trupa tjerë punues të Kuvendit, në proporcion me shkallën e pjesëmarrjes”.

Hydajet Hyseni tha se Komisioni për Integritim Evropian ka propozuar tri amendamente. Amendamenti i parë propozon që të shtohet një kapitull i ri me dy rregulla që kanë të bëjnë me çështjet e agjendës evropiane në Kuvendin e Kosovës.

Fatmire Berisha tha se ky amendament është propozuar të hyjë para neneve që rregullojnë punën në Kuvend, dhe mendon se duhet të sistemohet pas punëve të Kuvendit.

Komisioni miratoi amendamentin 1 të Komisionit për Integritim Evropian si vijon:

Amendamenti 9

1. Një kapitull i ri në kuadër të Rregullores së Punës të krijohet para kapitullit XII , si vijon:

KAPITULLI XI A

ÇËSHTJET E AGJENDËS EVROPIANE NË KUVENDIN E KOSOVËS

Rregulla 53a: Raport i Qeverisë mbi procesin e Integritimit Evropian

1. Kuvendi i Kosovës çdo gjashtë muaj do të shqyrtoj një raport nga Qeveria mbi procesin e Integritimit Evropian të Kosovës.
2. Raportet mbi procesin e Integritimit Evropian të Kosovës do të përfshijnë së paku informacionet vijuese:
 - a) Zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për gjashtë muajt e fundit;
 - b) Zbatimin e Planit qeveritar të Veprimit për Partneritet Evropian;
 - c) Zbatimin e rekomandimeve të Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën;
 - d) Prioritetet e Qeverisë për gjashtë muajt e ardhshëm karshi procesit të Integritimit Evropian të Kosovës.

Rregulla 53b: Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës

1. Kuvendi i Kosovës çdo vit do të miratojë Planin e Veprimit për Integritim Evropian.

2. Plani vjetor i Veprimit për Integrim Evropian do të pasqyrojë rekomandimet dhe sfidat e identifikuar në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovë si dhe prioritetet e cekura në Partneritetin Evropian.
3. Kuvendi i Kosovës çdo tre muaj do të diskutojë gjatë një seance plenare zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit për Integrim Evropian.
4. Kryesia me propozim të Komisionit të Integritimit Evropian, do të miratojë procedurat/udhërrëfyesin për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit vjetor të Veprimit për Integrim Evropian.

Hydajet Hyseni në vazhdim tha se amendamenti 2 i Komisionit për Integritime Evropiane, është si vijon: Në Rregullën 33, paragrafi 2 pas pikës (d) shtohet *pika e re si në vijim:*

„Tabelat e përputhshmërisë që analizojnë përputhjen e projekt-ligjit me legjislacionin e BE-së”

Anëtarët e Komisionit konstatuan se ky amendament është propozuar nga Komisioni më lartë dhe mbetet pa subjekt gjegjësisht pa përkrahjen e Komisionit .

Hydajet Hyseni në amendamentin 3 të Komisionit për Integritime Evropiane propozohet që në Rregullën 42. pas paragrafit 2të shtohet paragraf i ri si në vijim: „Asnjë deputet nuk mund të jetë në të njëjtën kohë anëtar i Kryesisë dhe Kryetar i Komisionit”.

Ky amendament është jashtë suazave të Komisionit për Integritime Evropiane dhe propozoi që të mos mbështetet nga Komisioni.

Besa Gaxherri propozoi që ky amendament të përkrahet sepse mendon se është absurde që një anëtarë i Kryesisë të jetë edhe kryetar i Komisionit.

Lidhur me këtë amendament diskutuan: Besa Gaxherri, Hydajet Hyseni e Ahmet Isufi.

Hydajet Hyseni konstatoi se amendamenti 3 i Komisionit për Integritime Evropiane, radhitet për seancë plenare pa mbështetje të Komisionit, meqë nuk është arritur pajtueshmëri në Komision. Kjo çështje mund të shtrohet në seancë plenare nga ndonjë deputet apo grup parlamentar.

Komisioni rekomandoi që në Projekt- Rregullore të bëhen edhe këto korrigjime :

-Në Kreun IV, rregulla 13 si dhe dispozitatat tjera kalimtare të dallohen me format më të vogël shkronjash (10p).

- Në shtojcën nr. 2 pika 10 dhe kudo në tekst ku haset emërtimi “**Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media**” zëvendësohet me emërtimin “**Komisioni për Administratë Publike Pushtet Lokal dhe Media**”

- Në shtojcën nr. 2 pika 16 të fshihet fjalia e fundit.

Daut Beqiri për mënyrën e procedimit të Projekt-Rregullores për miratim në seancë plenare , propozoi që të paraqiten të gjitha amendamentet me një tekst të përbashkët final, që të jetë procedura e shqyrtimit më e letë.

Ahmet Isufi propozoi që kjo çështje të vendoset në takimin e përbashkët të hënën me shefat e grupeve parlamentare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E hartoi:

Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit

Hydajet Hyseni -Kaloshi

